**VENDIM**
**Nr. 575, datë 10.7.2013**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 5, 21 pika 2, 24 pika 5, 25 pika 7, 42 pika 3, e 49 të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha institucionet, qendrore dhe vendore, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**RREGULLAT**
PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi dhe objekti

Këto rregulla përcaktojnë veprimet përgatitore për dhënien e një kontrate me koncesion/partneritet publik privat, vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjes dhe trajtimit të propozimeve të pakërkuara, si dhe procedurën dhe kriteret për vlerësimin dhe miratimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat që kërkojnë mbështetje financiare në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

### Neni 2
### Kufijtë monetarë

Për qëllime të zbatimit të këtyre rregullave kufiri i ulët monetar është 5 milionë lekë.

## KREU II
## RREGULLA TË VEPRIMEVE PËRGATITORE TË DHËNIES ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

### Neni 3

## Studime paraprake

1. Para fillimit të një procedure për dhënien e një kontrate me koncesion/partneritet publik privat, autoriteti kontraktues kryen veprimet paraprake të parashikuara në nenin 16 pika 3 të ligjit.

2. Bazuar në dispozitat e nenit 17 të ligjit, pikënisja e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit/partneritetit publik privat mund të jetë:

a) procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori;

b) analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit; ose

c) projektide të nxitura nga prioritetet e politikave.

3. Si fazë të parë të studimit të fizibilitetit, autoriteti kontraktues përgatit studimin paraprak, i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit. Ai duhet të përmbajë të paktën sa më poshtë vijon:

a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit, kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut;

b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;

c) përshkrimin e përgjithshëm të projektit;

ç) legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit;

d) në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërisht ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private;

dh) në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërisht një subjekt privat;

e) përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;

ë) bashkërendimin me politikat e përgjithshme të investimeve, sektoriale apo rajonale;

f) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;

g) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;

gj) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion;

h) alternativat e alokimit të riskut financiar, teknike dhe operacionale ndërmjet palës publike dhe subjektit privat;

i) konkluzionet dhe rekomandimet e zbatimit të mundshëm dhe rregullimet operacionale për projektin/projektet e mundshme, duke përfshirë modelet e zbatueshme/të përshtatshme të partneritetit publik privat.

4. Autoriteti kontraktues bazuar në informacionin, konkluzionet, si dhe rekomandimet e siguruara nga dokumenti i studimit paraprak, mund të vendosë:

a) të ndërpresë studimin dhe të shtyjë ose të refuzojë plotësisht zbatimin e projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit mbi mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare, apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm; ose

b) të vazhdojë me përgatitjen e studimit të fizibilitetit.

5. Në rastin kur, sipas rezultateve paraprake të studimit, duket që projekti i parashikuar do të kërkojë mbështetje financiare, autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e

Financave para se të kalojë në fazën e ardhshme, d.m.th. në studimin e fizibilitetit. Njoftimi ka qëllimin e vetëm për të mbajtur të informuar Ministrinë e Financave në lidhje me ndikimin e mundshëm buxhetor dhe nuk nënkupton një miratim të veçantë nga Ministria në këtë fazë.

Neni 4

## Studimi i fizibilitetit

1. Autoriteti kontraktues harton studimin e fizibilitetit përpara se të ndërmarrë angazhim për realizimin e projektit. Studimi i fizibilitetit siguron shqyrtimin dhe vlerësimin e aspekteve teknike, ekonomike dhe tregtare të një projekti të propozuar, të cilat do të jenë baza për vendimin e investimit.

2. Faza e dytë e studimit të fizibilitetit do të detajojë informacionin e përfshirë në studimin paraprak dhe përmban veçoritë kryesore të projektit, bazuar në analizën teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe analizën e ndikimit mjedisor dhe social, që kryhen në funksion të investimit të planifikuar.

3. Faza e fundit e studimit të fizibilitetit do të fokusohet në analizimin e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion/PPP është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

4. Në rastet kur autoriteti kontraktues e gjykon të nevojshme, kërkon bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat.

Neni 5

## Analiza teknike

1. Analiza teknike është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe ka si objektiv kryesor të demonstrojë se projekti mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa risqe të paarsyeshme teknike.

2. Analiza teknike duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) sfondin e projektit.

- iniciatorin e projektit;
- historinë e shkurtër të projektit;
- studimet e kryera tashmë, të tilla si: studimet e parainvestimeve, studimet mbështetëse, hulumtimet, rilevimet e trojeve;
- konceptin e projektit dhe objektivat kryesorë;
- përfituesit e projektit;

b) vendndodhjen dhe truallin.

- vendndodhjen dhe, nëse është rasti, listën e alternativave të mundshme të trojeve;
- sipërfaqen totale që do të zihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të përkohshme;
- statusin ligjor të tokës që do të zihet;
- pasuritë e tjera publike, të cilat do të përdoren, nëse ka ndonjë të tillë;

c) kushtet lokale.

- klima dhe fenomenet natyrore specifike për zonën;
- topografinë (duhen bashkëlidhur studimet topografike);
- gjeologjinë dhe sezmicitetin (duhen bashkëlidhur studimet/raportet gjeoteknike me rekomandime për themelet);
- gjendja aktuale e rrjetit dhe e lidhjes së shërbimeve;
- disponueshmëria e rrugëve hyrëse, nëse ka ndonjë të tillë;

ç) përshkrimin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit. Ky seksion siguron kryesisht rezultatet që pritet të arrihen dhe nuk përshkruan në mënyrë të detajuar se si do të arrihen.

- përshkrimin e punëve kryesore civile që do të realizohen;
- metodat e ndërtimit;
- teknologjinë dhe pajisjet, të cilat mendohen të përdoren;

- parametrat kryesorë të projektit si: kapacitetet, sipërfaqet, volumet, gjatësitë, dhe tregues të tjerë të veçantë;

- listën e standardeve teknike përkatëse që do të vëzhgohen;

d) periudha e vlerësuar e ndërtimit (në muaj).

3. Sa herë që jepen punime civile për t'u realizuar, analiza teknike duhet të përmbajë, pjesët përkatëse të skicuara, si vijon:

a) planin e vendndodhjes së zonës (1:25000 - 1:5000);

b) planin e përgjithshëm (1: 2000 - 1:500);

c) planet e përgjithshme dhe seksionet e arkitekturës, rezistencës, instalimeve; ç) planet e veçanta, profilet gjatësore, profilet tërthore, sipas kërkesës.

Neni 6

## Ndikimet mjedisore dhe sociale

1. Përveç trajtimit të argumentimit ekonomik, studimi i fizibilitetit përcakton ndikimin mjedisor dhe social të projektit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Studimi identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht. Ai duhet të tregojë, gjithashtu, edhe masat parandaluese që duhen ndërmarrë për të siguruar përputhjen me standardet e BE-së për mjedisin.

3. Studimi merr parasysh aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti, ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

Neni 7

## Analiza ekonomike dhe financiare

1. Analiza ekonomike dhe financiare është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe objektivi i saj kryesor është të përcaktojë "vlerën e parasë" së projektit.

2. Studimi i fizibilitetit shpreh një vlerësim të investimit në total, kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe çdo të ardhur që pritet të krijohet, në të gjithë kohëzgjatjen e projektit.

3. Kostot e drejtpërdrejta të investimeve lidhen në mënyrë specifike me ndërtimin e objekteve të reja dhe mund të përmbajnë, por nuk kufizohen në shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, teknike dhe të menaxhimit të projektit, kostot e projektimit, kostot e tokës apo të blerjes së një aseti të ri, kostot e përgatitjes së truallit, kostot e ndërtimeve dhe të vënies në funksionim, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera.

4. Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes përfshijnë kostot e mbajtjes së aseteve gjatë ciklit të plotë të projektit në gjendjen e kërkuar për të dhënë rezultatet e specifikuara, dhe mund të përfshijnë kostot e lëndëve të para, mjetet dhe pajisjet, si dhe kostot e personelit të shoqëruara me mirëmbajtjen.

5. Kostot e drejtpërdrejta operative lidhen me funksionimin e përditshëm të objektit dhe përfshijnë koston e plotë të personelit (ku futen pagat, përfitimet e punonjësve, detyrimet për kontributet e pensioneve, kontributet e sigurimeve, trajnimin dhe zhvillimin, pushimet vjetore, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të pritshme shtesë), kostot e shërbimeve, lëndët e para dhe materialet e konsumit, kostot e drejtpërdrejta të menaxhimit, si dhe shpenzimet e sigurimit.

6. Kostot indirekte të projektit janë një pjesë e kostos së administrimit të objektit, dhe përfshijnë kostot e kohës dhe të punës së drejtuesve të lartë, personelit, kontabilitetit, faturimit, shërbimeve ligjore, qirasë, komunikimet dhe burime të tjera institucionale të shfrytëzuara nga projekti.

7. Të ardhurat e projektit përfitohen nga:

a) përdoruesit fundorë që paguajnë për shërbimin apo për një pjesë të tij; dhe/ose

b) përdorimi i aseteve të institucionit.

8. Realizueshmëria ekonomike e projektit do të pasqyrohet nga tregues të ndryshëm të performancës financiare, të tillë si: fluksi i arkës (Cash-Flow), vlera aktuale neto (NPV), norma e brendshme e kthimit (IRR), periudha e vetështlyerjes (PBP) dhe analiza kosto-përfitim (CBA).

9. Përballueshmëria tregon nëse të ardhurat e përgjithshme të projektit janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktor, ose e të dyve, për të paguar tarifat dhe/ose tarifat e shërbimeve për objektin që do të jenë rezultat i projektit. Kjo përfshin kontrollimin e kostos fiskale të projektit, si në aspektin e pagesave të rregullta ashtu edhe në atë të riskut fiskal, si dhe përcaktimin nëse kjo mund të rregullohet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale.

10. Përshtatshmëria financiare tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar.

11. Realizohet një analizë cilësore dhe sasiore risku në mënyrë që të identifikohet dhe të vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin. Ky informacion përdoret për zhvillimin e strategjive për menaxhimin e riskut dhe do të jetë një bazë e mirë për alokimin e risqeve midis partnerëve publikë dhe privatë. Gjatë analizës mund të merren parasysh kategoritë e mëposhtme të risqeve, por jo vetëm:

a) risqet e trojeve: lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e vendndodhjes së projektit, të tilla si: kostoja dhe koha e marrjes së truallit, lejet e nevojshme ose sigurimi i së drejtës së kalimit për një rrugë, efekti i kushteve gjeologjike ose i kushteve të tjera të truallit, dhe kosto e plotësimit të standardeve mjedisore;

b) risqet e projektimit, ndërtimit dhe të vënies në punë: lidhen me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë se sa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se aseti nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit;

c) risqet e funksionimit: lidhen me suksesin e operacioneve, duke përfshirë riskun e ndërprerjes së shërbimit ose të disponueshmërisë së aseteve, riskun që ndonjë ndërveprim rrjeti nuk punon siç pritej, ose që kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes së objektit është e ndryshme nga sa pritej;

ç) risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregtare: lidhen me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej, ose që të ardhurat nuk janë mbledhur siç pritej;

d) risqet ekonomike ose financiare: lidhen me ndryshimet në normat e interesit, kurset e këmbimit ose inflacionit që ndikojë negativisht në rezultatet e projektit;

dh) risqet e pronësisë së aseteve: risqet që lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia vjetërohet ose, që vlera e aseteve në fund të kontratës është e ndryshme nga sa pritej;

e) risqet politike: lidhen me vendimet politike, që mund të ndikojnë negativisht mbi

projektin;

ë) risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor: risku që një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në tatimet e përgjithshme të korporatave ose në rregullat që rregullojnë këmbimin e monedhës, ose riatdhesimin e fitimeve;

f) risqet e forcës madhore: risqet që lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.

12. Analiza e ndjeshmërisë paraqet informacionin në një mënyrë që lejon të kuptohet saktësisht se çfarë është duke u supozuar si kusht bazë, dhe se si rezultatet përfundimtare do të ndikoheshin nga ndryshimet në supozime të tilla. Kjo është arritur nëpërmjet kryerjes së testeve të ndryshme të ndjeshmërisë dhe nëpërmjet krahasimit të rezultateve me ato që bazohen në supozime të ndryshme për kushtin bazë që rezulton në të paktën tri variacione të fizibilitetit, në veçanti kur të ardhurat e projektit nxirren nga përdoruesit.

Neni 8

## Arsyetimi i vendimit koncesionit/PPP-së

1. Bazuar në rezultatet paraprake të analizës së ndërmarrë në përputhje me nenet 3 deri 5 të këtyre rregullave, autoriteti kontraktues vendos:

a) nëse është konfirmuar leverdishmëria dhe qëndrueshmëria e projektit; dhe

b) nëse forma koncesion/PPP duket si modeli më i përshtatshëm për zbatimin e projektit.

2. Në rastin kur përgjigjet për të dyja çështjet e parashikuara në pikën 1 janë pozitive, studimi i fizibilitetit vazhdon me arsyetimin e vendimit të koncesionit/PPP-së.

3. Arsyetimi i vendimit të koncesionit/PPP-së kryhet duke filluar me Krahasuesin e Sektorit Publik dhe duke përdorur modele të përshtatshme financiare, të tilla si metodologjia e Krahasuesit Publik Privat ose modeli "Hije".

4. Krahasuesi i Sektorit Publik (KSP) është llogaritja e vlerës aktuale neto të kostove totale neto të projektit, në qoftë se kjo do të arrihet në bazë të një metode të prokurimit tradicional. Krahasuesi i Sektorit Publik përbëhet nga flukset e mjeteve monetare që lidhen me:

a) krahasuesin bazë të sektorit publik, i cili paraqet shpenzimet totale të parashikuara në paragrafët 3-6, të nenit 7 të këtyre rregullave, minus vlerën e të ardhurave që mund të mblidhen siç është parashikuar në paragrafin 7 të nenit 7;

b) përshtatjen e neutralitetit konkurrues, e cila përfaqëson avantazh konkurrues neto që i shkon sektorit publik në saje të statusit të tij; dhe

c) përshtatjen e risqeve specifike të projektit, në varësi të alokimit të riskut mes palëve publike dhe private.

Të gjitha flukset monetare të ardhshme të projektit shndërrohen në një kosto aktuale neto nëpërmjet zbatimit të normës së duhur të skontimit.

5. Si rregull i përgjithshëm, alokimi i riskut merr në konsideratë parimin se pala, e cila do të mbajë riskun, është ajo, e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij. Mund të përdoren tri llojet e alokimeve të riskut si më poshtë:

a) risku i mbajtur – risqet që do të mbahen nga autoriteti kontraktues;

b) risku i transferueshëm – risqet që do të transferohen te partneri privat;

c) risku i përbashkët – risqet që do të mbajnë të dyja palët, siç është rënë dakord në kontratë.

6. Alokimi i riskut do të përdoret, gjithashtu, si një mjet themelor për të cilësuar nëse koncesioni/PPP është klasifikuar si "brenda" ose "jashtë" bilancit të qeverisë në bazë të rregullave të Sistemit Europian të Llogarive (ESA95), sipas mënyrës së

kombinimit të alokimeve të tri llojeve të mëposhtme të risqeve:

a) risku i ndërtimit;

b) risku i disponueshmërisë;

c) risku i kërkesës.

7. Nëse krahasimi mes alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP- së tregon se zgjidhja e dytë ofron vlerën më të mirë të parasë, autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP. Në qoftë se krahasimi midis alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se

zgjidhja e dytë nuk ofron vlerën më të mirë të parasë, atëherë autoriteti kontraktues rishqyrton mundësinë për të realizuar projektin duke përdorur alternativën e prokurimit publik.

8. Shqyrtimi përfundimtar i të gjitha kërkesave ligjore për zbatimin e projektit bëhet së bashku me një vlerësim të kapacitetit të brendshëm të institucionit zbatues dhe të institucioneve të tjera që ndërmarrin detyra të ndryshme që lidhen me zhvillimin e projektit.

Neni 9

## Rezultatet e studimit të fizibilitetit

1. Në thelb, rezultatet e studimit të fizibilitetit duhet të tregojnë se:

a) projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktues;

b) projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;

c) projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;

ç) alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.

2. Paraqitja e studimit të fizibilitetit bëhet sipas formularit standard, i cili është pjesë përbërëse e dokumenteve standarde të koncesioneve/PPP-ve.

3. Vetëm projekti që përmbush të gjitha kushtet e pikës 1 të këtij neni mund të vijojë me shpalljen e procedurës së dhënies me koncesion/PPP, ose të paraqitet për miratim në Ministrinë e Financave, nëse një miratim i tillë është i nevojshëm në përputhje me nenin 42 të ligjit për koncesionet dhe PPP-të.

KREU III

VLERËSIMI I PRANUESHMËRISË, PËRMBAJTJES DHE TRAJTIMIT TË PROPOZIMEVE TË PAKËRKUARA

Neni 10

## Rregullat e përgjithshme për paraqitjen e propozimeve të pakërkuara

1. Çdo operator ekonomik ose grup operatorësh ekonomikë, referuar më poshtë si propozuesi, mund të paraqesë një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP dhe autoriteti kontraktues i analizon propozimet e tilla, me kusht që:

a) propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve që parashikohen në nenin 4 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat;

b) propozimi nuk lidhet me një projekt, për të cilin tashmë ka filluar ose është shpallur procedura për dhënien e tij.

2. Propozimi i pakërkuar i dorëzohet vetëm autoritetit kontraktues, të cilit ligji i jep autoritetin të ndërmarrë procedurën e dhënies së asaj kontrate të koncesionit/PPP-së.

3. Propozimi i pakërkuar mund të detajohet, në mënyrë që të trajtojë projektin në secilën prej formave të mëposhtme:

a) forma minimale, siç parashikohet në nenin 11 të këtyre rregullave;

b) forma minimale dhe analiza gjithëpërfshirëse teknike, ekonomike dhe financiare;

c) një studim fizibiliteti i zhvilluar plotësisht, duke përfshirë arsyetimin e vendimit për dhënien me koncesion/PPP.

Neni 11

## Propozimi i pakërkuar në formë minimale

1. Propozimi i pakërkuar i paraqitur në këtë formë, përmban të paktën informacionin që përcakton projektin në një nivel të përgjithshëm dhe që lejon autoritetin kontraktues që të bëjë një vlerësim paraprak të aspekteve të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë, si dhe nëse propozimi duket të jetë i realizueshëm dhe në interes të publikut apo jo.

2. Propozimi i pakërkuar, sipas përcaktimit në pikën 1, përmban të paktën sa vijon:

a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore, kontekstin e zhvillimit dhe, nëse është e përshtatshme, një panoramë të tregut;

b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;

c) përshkrim të përgjithshëm të projektit;

ç) përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;

d) bashkërendimin me politikat e investimeve të përgjithshme, sektoriale apo rajonale;

dh) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të së cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;

e) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare; ë) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike;

f) alternativat e alokimit të risqeve financiare, teknike dhe operacionale ndërmjet palës publike dhe palës private.

Neni 12

## Vlerësimi paraprak

1. Faza e parë e vlerësimit paraprak është për të verifikuar nëse kushtet e parashikuara në nenin 10, janë plotësuar apo jo dhe se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me pikën 2 të nenit 11.

2. Nëse propozimi nuk përmbush kushtet, atëherë autoriteti kontraktues refuzon propozimin dhe informon propozuesin në lidhje me atë vendim.

3. Edhe kur propozimi i plotëson kushtet, autoriteti kontraktues mund të refuzojë propozimin nëse projekti është i panevojshëm. Vendimi do t'i komunikohet propozuesit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit.

4. Nëse propozimi i plotëson kushtet dhe autoriteti kontraktues nuk ka vendosur ta refuzojë atë, sipas pikës 3 të këtij neni, faza e dytë e vlerësimit paraprak do të jetë analiza e studimit paraprak, bazuar në informacionin e dhënë në propozimin e pakërkuar.

5. Autoriteti kontraktues vlerëson propozimin në mënyrë që të përcaktojë nëse:

a) objektivat e projektit janë të përcaktuar qartë dhe të arritshëm;

b) objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten brenda prioriteteve strategjike të autoritetit kontraktues;

c) nuk ka pengesa ligjore ose kufizime për zbatimin e projektit dhe/ose për të hyrë në një kontratë koncesioni/PPP;

ç) projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara, dhe pa rreziqe të paarsyeshme teknike;

d) projekti duket të ketë qëndrueshmëri ekonomike;

dh) projekti duket të jetë në gjendje të tërheqë garantuesit/mbështetësit financiarë, duke siguruar kthimin e fuqishëm dhe të arsyeshëm financiar;

e) niveli i propozuar i alokimit të riskut nga subjektet e sektorit publik dhe privat është racional dhe i arsyeshëm;

ë) mbështetja e duhur financiare mund të përshtatet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale.

6. Rezultatet e të dhënave paraprake materializohen në një studim paraprak. Periudha për përfundimin e studimit duhet të jetë jo më shumë se 90 ditë nga data e paraqitjes së propozimit. Gjatë kësaj periudhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacione shtesë nga propozuesi.

7. Bazuar në informacionin e shqyrtuar, dhe rekomandimin e dhënë nga studimi paraprak, autoriteti kontraktues mund të vendosë:

a) të refuzojë propozimin dhe të heqë dorë nga zbatimi i projektit; ose

b) të pranojë propozimin dhe të fillojë hartimin e studimit të fizibilitetit.

8. Vendimi për ta refuzuar ose pranuar propozimin do t'i komunikohet propozuesit brenda afatit kohor të parashikuar në paragrafin 6 të këtij neni.

9. Në rast refuzimi, autoriteti kontraktues kthen të gjithë dokumentacionin e paraqitur si propozim i pakërkuar.

Neni 13

## Detajimi i studimit të fizibilitetit

1. Para marrjes së vendimit për investime, autoriteti kontraktues harton një studim fizibiliteti, në përputhje me këto rregulla.

2. Në rastin kur propozuesi ka dorëzuar një propozim që përmban jo vetëm informacione minimale e të nevojshme për vlerësimin paraprak, por edhe analizën e plotë teknike, ekonomike dhe financiare, ose në rastin kur propozuesi ka paraqitur një studim të fizibilitetit të zhvilluar plotësisht, autoriteti kontraktues mund të përdorë të gjitha ose një pjesë të informacionit për të hartuar studimin e fizibilitetit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Pavarësisht se sa i detajuar është propozimi, autoriteti kontraktues verifikon me kujdes të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për kontekstin e analizës.

4. Projekti trajtohet si produkt i autoritetit kontraktor dhe rezultatet e studimit të fizibilitetit duhet të tregojnë se:

a) projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm, dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktor;

b) projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;

c) projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;

ç) dhënia e kontratës me koncesion/PPP është ekonomikisht më e favorshme se dhënia e saj me prokurim publik.

5. Autoriteti kontraktues i komunikon propozuesit nëse projekti mund të zbatohet apo jo, në bazë të rezultateve përfundimtare të studimit të fizibilitetit. Pranimi përfundimtar i projektit duhet të miratohet nga Ministria e Financave, nëse është e nevojshme sipas nenit 42 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

6. Afati për përfundimin e studimit të fizibilitetit, në rastin e një propozimi të pakërkuar fillon nga data e dhënies së vendimit siç parashikohet në pikën 8 të nenit 12, dhe

është jo më shumë se:

a) katër muaj, në rastin kur propozuesi ka paraqitur një studim fizibiliteti të zhvilluar plotësisht;

b) gjashtë muaj, në rastin kur propozuesi nuk ka paraqitur një studim fizibiliteti të zhvilluar plotësisht, por ka dorëzuar të plotë analizën teknike, ekonomike dhe financiare;

c) dy vjet, në rastin kur propozuesi ka dorëzuar vetëm formën minimale të propozimit.

7. Në rast refuzimi, autoriteti kontraktues do të kthejë të gjithë dokumentacionin e paraqitur në propozimin e pakërkuar.

Neni 14

## Propozimet e pakërkuara në kontekstin e procesit të koncesionit/PPP-së

1. Nëse projekti pranohet, atëherë autoriteti kontraktues mund të nisë procedurën për dhënien e kontratës. Parimi bazë është se dhënia e kontratës duhet të bëhet përmes një procesi transparent dhe konkurrues në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

2. Para nisjes së procedurës së përzgjedhjes, propozuesit do t'i kërkohet të identifikojë në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, që lidhet me zgjidhjet teknike ose teknologjitë e reja, të cilat ata duan të mbrojnë. Klasifikimi i gjithë dokumentacionit të propozimit si sekret, nuk është i pranueshëm.

3. Teknologjia "e re" duhet të ketë të paktën një prej karakteristikave të mëposhtme:

a) një proces, projektim, metodologji apo koncept inxhinierik të njohur, i cili ka demonstruar aftësinë e tij për të reduktuar ndjeshëm kostot e ndërtimit, për të përshpejtuar realizimin e projektit, për të përmirësuar sigurinë, për të rritur performancën e projektit, për të zgjatur jetën ekonomike, për të zvogëluar shpenzimet e mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve, ose për të zvogëluar ndikimin negativ mjedisor, problemet apo çrregullimet sociale/ekonomike si gjatë fazës së ndërtimit, ashtu edhe gjatë fazës së operimit të projektit;

b) një proces, për të cilin propozuesi i projektit ose cilido anëtar i sipërmarrjes së përbashkët/konsorciumit zotëron të drejta ekskluzive, qoftë në nivel botëror, qoftë në nivel rajonal; ose

c) një koncept, projektimi, metodologjik apo inxhinierik, për të cilën propozuesi ose një anëtar i konsorciumit propozues apo organizata, zotëron të drejtën e pronësisë intelektuale.

4. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në qoftë se propozuesi ofron me të vërtetë një koncept ose teknologji të re.

5. Dokumentet e tenderit nuk duhet të zbulojnë teknologjinë e veçantë dhe të re të përshkruar nga propozuesi në propozimin e pakërkuar. Në një rast të tillë, specifikimet teknike përcaktohen kryesisht në aspektin e performancës dhe/ose të kërkesave funksionale.

Neni 15

## Shuma e rimbursimit

1. Kur procedura e dhënies së kontratës, e nisur në lidhje me propozimet e pakërkuara, finalizohet me nënshkrimin e kontratës, propozuesi ka të drejtë të përfitojë kompensimin e shpenzimeve të bëra gjatë përgatitjes së propozimit të pakërkuar, nëse ai ka marrë pjesë si ofertues në procedurën e dhënies së kontratës, por nuk është shpallur fitues.

2. Shuma e rimbursimit mund të përcaktohet nëpërmjet vlerës së përllogaritur të tregut për propozimin e projektit dhe duke marrë parasysh edhe karakteristikat e ndryshme

të propozimit, të tilla si: dobia, korrektësia, saktësia, niveli i detajimit e të tjera.

3. Shuma e rimbursimit nuk do të jetë më e ulët se 0,5% ose më të lartë se 2% të vlerës së koncesionit/PPP-së, në përputhje me kriteret treguese të mëposhtme:

a) 0,5% - 0,75%, nëse propozuesi i ka dorëzuar propozimin e pakërkuar në një formë minimale;

b) 0,75% - 1,5%, nëse propozuesi ka dorëzuar analizën gjithëpërfshirëse teknike, ekonomike dhe financiare;

c) 1,5% - 2%, nëse propozuesi ka paraqitur një studim të plotë fizibiliteti.

4. Shuma e saktë përcaktohet nga autoriteti kontraktues mbi bazën e propozimit të propozuesit, i cili në çdo rast duhet ta argumentojë propozimin e tij.

5. Nëse autoriteti kontraktues përcakton rimbursimin në shumë më të ulët se ajo e propozuar nga kërkuesi, ai duhet të argumentojë vendimin e tij.

Neni 16

## Dhënia e bonusit në rastet e propozimeve të pakërkuara për hidrocentrale

1. Në rast pranimi të një propozimi të pakërkuar për hidrocentrale, fillon procedura përzgjedhëse, e cila favorizon paraqitësin e propozimit të pakërkuar duke i dhënë një bonus për rezultatin tekniko-financiar të arritur gjatë periudhës përzgjedhëse deri në një maksimum prej 10% të pikëve.
2. Autoriteti kontraktor i paraqit dokumentacionin e plotë Këshillit të Ministrave, i cili miraton me vendim pikët që jepen si bonus për propozuesin.

KREU IV
PROCEDURA DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN DHE MIRATIMIN E PROJEKTEVE TË KONCESIONEVE/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT QË KËRKOJNË MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 17

## Miratimi para shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/PPP

1. Projektet e koncesione/PPP-ve që kërkojnë mbështetje financiare dorëzohen në Ministrinë e Financave për miratim, pavarësisht modelit të parashikuar të koncesionit/PPP-së dhe mënyrës, në të cilën ato janë nisur, d.m.th. si propozim i kërkuar apo i pakërkuar.
2. Autoriteti kontraktues kërkon miratimin sipas pikës 1 të këtij neni, përpara shpalljes së procedurës për dhënien me koncesion/PPP të një kontrate.
3. Përveç miratimit të përshkruar në pikën 2 të këtij neni, duhet të miratohen nga Ministria e Financave edhe projektet e koncesioneve/PPP-ve që pësojnë ndryshime të kontratës apo transferim të saj, në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, kur ndryshimet ose transferimet ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, Buxhetin e Shtetit ose ndryshojnë në çfarëdo mënyre mbështetjen financiare.

Neni 18

## Procedur a

1. Kërkesa për miratimin e Ministrisë së Financave paraqitet në formë të shkruar dhe shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 18 të këtyre rregullave.
2. Ministria e Financave analizon dhe vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e marrë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këto rregulla.
3. Ministria e Financave nxjerr vendimin për miratimin ose refuzimin e projektit jo më vonë se 45 ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, nëse autoriteti kontraktues nuk ka marrë ndonjë kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit.

Në rast se autoriteti kontraktues ka marrë një kërkesë të tillë, atëherë afati zgjatet 15 ditë nga dita kur është marrë informacioni.

4. Kur një projekt është hartuar me ndihmën e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat ose të ekspertëve të jashtëm, atëherë Ministria e Financave nëpërmjet autoritetit kontraktues mund të kërkojë nga subjektet në fjalë një mendim shtesë për çështje që kanë rëndësi për objektin e analizës që është nën autoritetin e Ministrisë së Financave.

5. Në rast se autoriteti kontraktues nuk e ka nisur procedurën për dhënien e kontratës së koncesionit/PPP-së, brenda 2 vitesh nga marrja e miratimit, projekti duhet të paraqitet përsëri për miratim.

6. Ministria e Financave publikon në faqen e saj të internetit projektet e miratuara, jo më vonë se 20 ditë nga dita kur është bërë miratimi.

Neni 19

## Dokument acioni

1. Kërkesa për miratimin e Ministrisë së Financave shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) studimin e fizibilitetit dhe anekset shoqëruese, përfshirë një matricë të alokimit të riskut dhe Krahasuesin e Sektorit Publik (KSP), si dhe projekt kontratën dhe anekset shoqëruese;

b) argumentimin me shkrim të vendimit për dhënien e projektit me koncesion/PPP;

c) një raport cilësor dhe sasior mbi rreziqet që parashikohen të ndërmerren plotësisht ose pjesërisht nga partneri publik dhe një përshkrim të metodologjisë së vlerësimit sasior të riskut, si dhe masat e parashikuara publikisht për zbutjen e riskut;

ç) përshkrimin e projektit të propozuar të koncesionit/PPP-së;

d) raportin që paraqet implikimet fiskale vjetore të drejtpërdrejta dhe/ose të pritshme të projektit gjatë kohëzgjatjes së kontratës, përfshirë një përshkrim të burimeve të financimit për shërbimin e detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në pagesat e tarifave vjetore të disponueshmërisë, si dhe garancitë;

dh) raportin mbi përmbushjen e kushteve për trajtimin jashtë bilancit të projektit, nëse aplikohet;

e) informacionin mbi projektet ekzistuese të koncesioneve/PPP-ve dhe angazhimet buxhetore që rrjedhin prej tyre;

ë) pasqyrat financiare për dy vitet e mëparshme të autoritetit kontraktues.

2. Dokumentacioni shtesë që mund të dorëzohet nga autoriteti kontraktues me kërkesë të Ministrisë së Financave, nëse zbatohet dhe është në dispozicion, mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

a) projektet/dokumentacionin/përshkrimet e kontratës;

b) kërkesat e subjektit për qëllime të veçanta;

c) blerjen dhe transferimet e të drejtave të pronësisë, të pasurive, të drejtave pasurore apo të drejtave të tjera reale;

ç) standardet e shërbimit dhe të mirëmbajtjes;

d) mekanizmat e përllogaritjes së tarifës së
disponueshmërisë; dh) kërkesat në lidhje me sigurimet;

e) akte të tjera ligjore, kontratat apo dokumentacioni, nëse është e nevojshme.

3. Dokumentacioni i përcaktuar nga ky nen, dorëzohet një kopje në formë të shkruar dhe një kopje në formë elektronike (CD apo forma të ngjashme me të).

4. Pas marrjes së dokumentacionit të përcaktuar nga ky nen, Ministria e Financave verifikon dokumentacionin dhe nëse vlerësohet i paplotë, kërkon plotësimin e tij.

5. Ministria e Financave publikon në faqen e saj të internetit një model të raporteve të përshkruara nga pika “c” në pikën “d” të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 20

## Procedura e analizës

1. Ministra e Financave:

a) përcakton ndikimet e menjëhershme dhe të mundshme fiskale për qëllimet e vlerësimit të përballueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe për qëllime të buxhetimit të detyrimeve dhe angazhimeve të tilla, kur është e përshtatshme;

b) përcakton përballueshmërinë fiskale, në lidhje me pajtueshmërinë e mbështetjes së parashikuar financiare (alokimet buxhetore), duke përfshirë risqet, me tavanet e buxhetit/borxhit të përcaktuara nga rregullat e buxhetit;

c) përcakton qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, në lidhje me projeksionet afatgjata (fluksin e parasë) dhe parashikimet (makroekonomike) të kapacitetit buxhetor dhe aftësinë për të përkrahur shërbimin e mbështetjes financiare dhe angazhimet e tjera kontraktuale të parashikuara nga projekti;

d) analizon risqet, kryesisht ato që merren përsipër plotësisht ose pjesërisht nga autoriteti kontraktues, për qëllimin e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së tyre dhe të kostove, si dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave për trajtim jashtë bilancit, nëse është e përshtatshme.

2. Për kryerjen e detyrave të përshkruara në paragrafin 1, Ministria e Financave merr parasysh sa më shumë që të jetë e mundur raportet e përshkruara në paragrafin 1 të nenit 18 të këtyre rregullave.

3. Ministria e Financave, gjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, mban në konsideratë kufirin maksimal të totalit të detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në pagesat e tarifave të disponueshmërisë së partneritetit publik privat, që mund të vendosen në nivel lokal dhe qendror.

4. Të gjitha çështjet e tjera që lidhen me trajtimin kontabël të koncesioneve/PPP-ve dhe buxhetimit për projektet e koncesioneve/PPP-ve, rregullohen sipas legjislacionit përkatës.

## Neni 21
## Vendimet e Ministrisë së Financave

1. Ministria e Financave me vendim:

a) miraton projektin, nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare janë të përballueshme dhe të qëndrueshme;

b) kundërshton projektin, nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare të projektit janë të papërballueshme dhe/ose të paqëndrueshme ose, nëse mundësia e risqeve të ndërmarra nga partneri publik, në projekt, janë të tilla që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe/ose qëndrueshmërinë e projektit.

2. Vendimi i përshkruar në pikën 1, duhet të jetë i argumentuar.

3. Në qoftë se Ministria e Financave nuk e merr vendimin brenda afateve të përcaktuara sipas këtyre rregullave, atëherë projekti quhet i miratuar.

4. Projektet e refuzuara mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të nevojshme dhe të paraqiten përsëri për miratim në Ministrinë e Financave.

## Neni 22
## Kërkesat buxhetore

1. Në bazë të tavanit të shpenzimeve për periudhën afatmesme të miratuar nga Këshilli i Ministrave, autoriteti kontraktues, gjatë hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme për institucionin përkatës, mban në konsideratë përfshirjen në këto kërkesa të kostos që lidhet me kontratat e partneritetit publik privat, që janë në proces shqyrtimi dhe që parashikohet të miratohen në periudhën afatmesme respektive.

2. Autoriteti kontraktues përpara dërgimit për miratim në Ministrinë e Financave të një projekti për partneritetin publik privat që kërkon mbështetje financiare, duhet të garantojë që kostot përkatëse të projektit janë të planifikuara të përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuara nga Kuvendi, si dhe brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

## Miratimi i ndryshimeve ose i transferimeve të kontratës

1. Kur një ndryshim ose transferim i kontratës së koncesionit/PPP-së i ndërmarrë në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat ndikon ose krijon riskun e ndikimit të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, Buxhetin e Shtetit ose që ndryshon në çfarëdo mënyrë mbështetjen financiare, atëherë një projekt i tillë i dorëzohet Ministrisë së Financave për miratim.

2. Autoriteti kontraktues paraqet me shkrim shkaqet e ndryshimit të propozuar dhe/ose të transferimit të kontratës, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

3. Përveç përshkrimit dhe dokumentacionit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, autoriteti kontraktues dorëzon, në masën e mundshme, raporte të përcaktuara nga pikat "c" dhe "d" të pikës 1 të nenit 18, në lidhje me ndikimet që ndryshimet dhe/ose transferimi i kontratës kanë mbi projektin për pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së tij.

4. Mbi bazën e analizës së kryer, Ministria e Financave vendos nëse ndryshimet e propozuara dhe/ose transferimi i kontratës së koncesionit/PPP-së dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e projektit, në kuptim të neneve 19 dhe 20 të këtyre rregullave.

5. Ministria e Financave jep miratimin jo më vonë se 20 ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë në bazë të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk kërkon informacion shtesë nga autoriteti kontraktues. Në rast se kërkohet një informacion i tillë, atëherë afati zgjatet 15 ditë nga dita kur është marrë informacioni.

KREU V

SHPALLJA DHE ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 24

## Dokumentet e tenderit

Për qëllim të zbatimit të pikës 2 të nenit 21 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, Agjencia e Prokurimit Publik përshtat setin e dokumenteve standarde të përdorura për procedurën e prokurimeve, me dokumentet standarde të procedurës së koncesioneve/PPP-ve, dhe i publikon ato.

Neni 25

## Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore

bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

2. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

3. Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

4. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet

të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

5. Në rast se, bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkim.

6. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. "Kërkesat ekonomike,financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje.

7. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

8. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jopërfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Neni 26

## Njoftimi i kontratës

1. Autoriteti kontraktues bën të njohur qëllimin e tij për të dhënë një kontratë me koncesion/PPP me anë të një njoftimi kontrate.

2. Njoftimi i kontratës botohet në një formular standard i cili duhet të përmbajë minimalisht:

a) emrin dhe adresën e autoritetit kontraktues;
b) emrin dhe adresën e personit përgjegjës;
c) llojin e autoritetit kontraktues;
d) objektin dhe llojin e kontratës;
e) kohëzgjatjen e kontratës;
f) vendndodhjen e objektit të kontratës;
g) informacionin ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik;
h) kriteret e përzgjedhjes së fituesit;
i) afatin kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;
j) afatin kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;
k) periudhën e vlefshmërisë së ofertave;
l) informacione plotësuese.

3. Njoftimi i kontratës është pjesë e dokumenteve standarde të koncesioneve/PPP-ve, dhe publikohet në formë elektronike në sistemin elektronik të prokurimit dhe në Buletinin e Prokurimit Publik.

Neni 27

## Dispozita kalimtare
## dhe të fundit

1. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, miraton dokumentet standarde në zbatim të këtij vendimi.

2. APP-ja harton udhëzime shpjeguese dhe manuale për procedurat e koncesioneve/PPP-ve, të detyrueshme për përdorim nga çdo autoritet kontraktues gjatë kryerjes së veprimtarive të koncesioneve/partneriteteve publike private.